

VENDIM
Nr. 729, datë 2.9.2015

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË TE MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, TË MJEDISEVE TË
ISH-GODINËS SË MINISTRISË SË MJEDISIT PËR AGJENCINË SHQIPTARE TË
ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE (AIDA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pasuritë e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të mjediseve të ish-godinës së Ministrisë së Mjedisit, për mjedise pune për zhvillimin normal të veprimtarisë administrative të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

2. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë apo t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Vendimi nr. 146, datë 18.2.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të mjediseve të ish-godinës së Ministrisë së Mjedisit”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama